



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

N j o f t i m
për shpallje konkurimi për vend të lirë pune

Bazuar në ligjin **LIGJ Nr. 98/2016 PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**, shpall konkurimin për vend të lirë pune për sekretar gjyqësor).

- Përshkrimi i përgjithshëm i punës për pozicionin e sekretarit gjyqësor sipas nenit 44 të ligjit **Nr. 98/2016, “PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

1. Sekretari gjyqësor kryen detyra procedurale, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.
2. Sekretari gjyqësor ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:
 - a) vërteton aktet e gjykatës dhe lëshon vërtetime apo kopje të njësuara me origjinalin të akteve procedurale gjyqësore. Kur përdoren pajisje regjistrimi apo pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;
 - b) është përgjegjës për krijimin e dosjeve dhe ndihmon gjyqtarin për mbajtjen e dosjeve sipas një rregulli të caktuar, si dhe për regjistrimin dhe zbatimin e urdhrave të shpallur apo të nxjerrë nga gjykatat dhe gjyqtarët;
 - c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
 - ç) ndihmon në çështje që lidhen me mbajtjen e dosjeve personale;
 - d) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave gjyqësore;
 - dh) ndihmon në krijimin e statistikave të gjykatës, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave;
 - e) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.
3. Veprimtari të tjera, të cilat kryhen rregullisht nga sekretarët gjyqësorë, renditen në përshkrimet standarde të punës, miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor.

-Kërkesat e veçanta për pozicionin Sekretar Gjyqësor, janë si më poshtë:

- Të ketë mbaruar arsimin e lartë Juridik (Bachelor + Master) .
- Të ketë eksperiencë pune.
- Të ketë trajnime profesionale të certifikuara në fushën e administrimit gjyqësor dhe të gjykimit.
- Të njohë dhe të përdorë programet bazë të punës në kompjuter dhe sistemin ICMIS.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të ketë njohuri të gjuhës angleze (me dokument) ose njohja e një gjuhe tjetër përbën avantazh.

-Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, brënda **datës 12.08.2019**, pranë Gjykatës të Rrethit Gjyqësor Elbasan (*Kancelari*), kopje të dokumentave të mëposhtëm:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.

- CV.
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave.
- Fotokopje të librezës së punës,
- Fotokopje të çertifikatave të trajnimeve apo kualifikimeve (nëse ka).
- Dokument të gjuhës së huaj.
- Vërtetim të gjendjes shëndetsore.
- Vetdeklarim i vërtetimit të gjendjes gjyqësore.
- Kontaktet (*numër telefoni dhe adresë email*) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit.
- Fotokopje e kartës së identitetit.

Mosparaqitja e plotë e dokumentave sjell skualifikim të kandidatit.

-Konkurimi është i hapur për nëpunësit e rinj dhe të të njëjtës kategori me procedurat e lëvizjes paralele dhe do të zhvillohet në *dy faza* ;

-Në fazen e parë do të kryhet **Verifikimi paraprak** i përmbushjes së kushteve minimale për lëvizjen paralele dhe kërkesave të veçanta në shpalljen për konkurim.

- Në fazen e dytë, **Intervista** e strukturuar me gojë, për kandidatët fitues të fazës së parë, do të zhvillohet **më datë 12.09.2019, ora 11.00**, pranë ambienteve të Gjykatës Elbasan.

-Fusha e njohurive, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në intervistë janë;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, ligji nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqsor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 152/2013 ”Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, Kodin e Procedurës Administrative, ligji nr. 9131, datë 08.9.2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, ligji nr. 9367, datë 07.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

-Data e daljes së rezultateve do të jetë **12.09.2019**.

-Njoftimi dhe komunikimi me kandidatët do të jetë nëpërmjet telefonit dhe adresës së e-mail të kandidatit.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR ELBASAN

Elbasan, 31 Korrik 2019